

**KONTRATË SHIT – BLERJE TË
KUOTËS SË KAPITALIT**

Sot, më datë 31.03.2022 është nënshkruar kjo Kontrate Shit-Blerje e Kuotës së Kapitalit (“**Kontrata**”), mes:

Lirim Fezollari, shtetas shqiptar, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë,

(ketu e me poshte referuar si “**Shitësi**”);

dhe

TOBACCO HOLDING GROUP Shpk., person juridik shqiptar, regjistruar më 24.05.2001 me NIPT K11724001B, me seli në Adresën: Njësia Bashkiake Nr.6, Rr. “Feridon Fezollari”, Ndërtesa THG, Ish Kombinati Ushqimor, Zona Kadastrale Nr.8240, Nr.Pas.2/163, Tiranë. Përfaqësuar nga Administratorja Valbona Begu, pajisur me Kartë Identiteti Nr.H16128105C/025463423

(ketu e me poshte referuar si “**Blerësi**”).

Shitesi dhe Blerësi ne vijim referuar individualisht edhe si “**Pale**” dhe bashkarisht si “**Palet**”


BAZA LIGJORE:

- Neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar;
- Statuti i DE HOLDING Shpk.;
- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve të DE HOLDING Shpk., datë 30.03.2022 (“**Vendimi i Asamblesë**”).

KUSHTE PARAPRAKE

MEQENËSE:

- A. Lirim Fezollari është bashkëortak i **DE HOLDING Shpk.**, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikimi NUIS L71402065J, me Seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 6, Rruga Feridon Fezollari, Ndertesa THG, Tiranë, përfaqësuar nga Administratorët Znj. Klodiana Kumaraku dhe Z. Arbër Salihu “**DE HOLDING**” ose “**Shoqëria**”
- B. Kapitali i Shoqerise eshte prej 300,000.00 Leke (*treqindmijë leke*), i përbërë nga 2 (dy) kuota me vlere nominale prej:



- Ortaku Shkëlqim Devolli, zotëron 1 kuotë me vlere 150,000.00 Leke (*njëqindepesëdhjetëmijë leke*), te cilat përfaqësojnë një pjesëmarrje prej 50% në kapitalin e Shoqerise; dhe
 - Ortaku Lirim Fezollari, zotëron 1 kuotë me vlere 150,000.00 Leke (*njëqindepesëdhjetëmijë leke*), te cilat përfaqësojnë një pjesëmarrje prej 50% në kapitalin e Shoqerise.
- C. Shitesi deshiron te shesë, dhe Bleresi pranon te bleje Kuotën me pjesëmarrjen prej 41% në shoqëri të Shitësit, me vlere 150,000.00 lekë (*njëqindepesëdhjetëmijë leke*), që zoterohet nga Shitesi ("**Kuota Target**");
- D. Shoqeria, ka miratuar Vendimin per këtë transaksion të kuotës dhe Ortaku Shkëlqim Devolli ka pranuar këtë transaksion duke hequr dorë nga kushti i parablerjes.

ATËHERË, bazuar në sa me siper, Palet pranojne te lidhin kete kontrate qe ekzekuton shitjen e Kuotes Target (ne vijim "**Kontrata**") si vijon:

Neni 1


OBJEKTI

- 1.1. Objekti i kësaj Kontrate është shitja e Kuotës Target të Shoqërisë nga Shitësi tek Blerësi. Blerja do të kryhet kundrejt pagimit të çmimit të Kontratës nga Blerësi tek Shitësi, nëpërmjet kreditimit në llogarinë bankare të Palës Shitëse, në datën e nënshkrimit të Kontratës.
- 1.2. Kushti për realizimin e Shitjes, do të jetë pagimi i çmimit të kësaj Kontrate nga Blerësi tek Shitësi.
- 1.3. Me nënshkrimin e Kontratës, pronësia e Shoqërisë do të jetë si vijon:
 - Ortaku Shkëlqim Devolli, zotëron 1 kuotë me vlere 150,000.00 Leke (*njëqindepesëdhjetëmijë leke*), te cilat përfaqësojnë një pjesëmarrje prej 50% në kapitalin e Shoqerise; dhe
 - Ortaku Tobacco Holding Group Shpk, zotëron 1 kuotë me vlere 150,000.00 Leke (*njëqindepesëdhjetëmijë leke*), te cilat përfaqësojnë një pjesëmarrje prej 50% në kapitalin e Shoqerise.

Neni 2

ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

- 2.1. Çmimi i Kuotës Target është prej 150,000.00 Leke (*njëqindepesëdhjetëmijë leke*).



2.2. Likudimi i çmimit të Kontratës, do të kryhet me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe me realizimin e pagimit, kjo Kontratë do të regjistrohet pranë QKB.

Neni 3

DEKLARIME DHE GARANCI

- 4.1. Shitesi deklaron dhe garanton se është i vetmi pronar dhe titullar i Kuotës Target dhe të të drejtave që rrjedhin prej saj.
- 4.2. Shitesi deklaron dhe garanton se Kuota Target është e lire nga cdo peng, privilegj, barre, apo çdo e drejte tjetër në favor të të tretëve.
- 4.3. Blerësi deklaron dhe garanton, se do të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga Shitja në kohë dhe në shumën e parashikuar.
- 4.4. Shoqëria me nënshkrimin e kësaj Kontrate, do të bëjë regjistrimin e ndryshimit të pronësisë së Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Palet angazhohen të zgjidhin me mirekuptim cdo mosmarreveshje që lidhet me interpretimin dhe/ose ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një gjë e tillë nuk është me mundur, mosmarreveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

SHITËSI

Lirim FEZOLLARI

BLERËSI

TOBACCO HOLDING GROUP Shpk.

Administratorja Valbona BEGU